

KMSHD-ja, takim online për unifikimin e mësimdhënies në Diasporë



Kryesia e Këshillit të Mësimit Shqip për Diasporë (KMSHD), në prani të përfaqësuesve të dyja shteteve shqiptare: Shqipërisë dhe Kosovës, mbajti një takim pune online me ministrin e Shtetit për Diasporën të Republikës së Shqipërisë z. Pandeli Majko; zëvendësministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës, z. Bekim Brestovci; drejtoreshën e Qendrës së Botimeve për Diasporën Dr. Mimoza Hysa dhe drejtoreshën e kabinetit të Ministrisë Shtetit z. Ada Ilija. Në takim u diskutua mundësia e njohjes së KMSHD-së nga institucionet e dy shteteve me qëllim unifikimin e shkollave shqipe të mësimit plotësues të gjuhës shqipe në Diasporë. Të gjitha palët shprehën gatishmërinë dhe shqyrtuan mundësitë për bashkëpunim të frytshëm në dobi të mësimdhënies në Diasporë. Takimi u përfundoi me gatishmëri dhe të gjitha palëve që të punojmë bashkërisht drejt qëllimit final unifikimit të shkollave shqipe, një hap i rëndësishëm përpara në ndërtimin e urave midis diasporës dhe të shteteve amë.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

AKD në bashkëpunim me MSHD-në dhuron librin “Politika Shtetërore për Diasporën” Rezidencës Studentore Universitare Nr. 1, Tiranë



Me qëllim ruajtjen e tij si libri i parë që përmban politikën shtetërore në fushën e diasporës në historinë e shtetit shqiptar Agjencia Kombëtare e Diasporës ka dhuruar sot 400 kopje të librit “Politika Shtetërore për Diasporën”, Rezidencës Studentore Universitare Nr. 1, Tiranë. Libri “Politika Shtetërore për Diasporën” është botim i Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe përmban materiale të cilat shërbejnë për informimin e publikut brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e veprimtarisë së institucioneve shtetërore si edhe politikën e legjislativës për Diasporën shqiptare. Politika shtetërore për Diasporën synon mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, nxitjen e angazhimit të tyre në jetën sociale dhe politike dhe rritjen e kontributit në vendin e origjinës.

“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”



“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Botimi dygjuhësh shqip-greqisht “Sirena e vogël” / “Udhëtimet e Guliverit”, falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën



Botimi dygjuhësh shqip-greqisht “Sirena e vogël” / “Udhëtimet e Guliverit”, falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën “Sirena e vogël” dhe “Udhëtimet e Guliverit”, dy përralla mjaft të dashura për fëmijët, pjesë e serisë “Klasikët Dygjuhësh” – projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe greqisht. “Sirena e vogël”, një ndër përrallat e famshme të shkruara nga autori danez Hans Christian Andersen, u botua për herë të parë në vitin 1837, si pjesë e një koleksioni përrallash për fëmijë. Është përshatuar në media të ndryshme, si: teatër muzikor, balet, opera dhe film. Ekziston edhe një statujë që portretizon sirenën në Kopenhagë, Danimarkë, ku historia u shkrua dhe u botua për herë të parë. Përralla “Udhëtimet e Guliverit” është një përshatje nga vepra satirike me të njëjtin titull e shkrimtarit dhe klerikut irlandez Jonathan Swift, botuar më 1726. Konsiderohet si një klasik në letërsinë botërore për fëmijë dhe jo vetëm. Vepra pati një sukses të menjëhershëm që në krye të herës. Dramaturgu anglez John Gay u shpreh për veprën se libri “është lexuar botërisht, nga këshilli i kabinetit deri në çerdhe”.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijjnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Kroaci/ Ambasada i dorëzon bibliotekës së Zagrebit librat e dhuruar nga QBD-ja



Ambasadori shqiptar në Kroaci Riza Poda gjatë ditës së sotme ka dorëzuar pranë Bibliotekës Qendrore Shqiptare të Zagrebit librat e dërguar falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën. Librat iu dhuruan drejtueses së kësaj biblioteke Dorotea Kerni, e cila është njëkohësisht mësuese e gjuhës shqipe dhe prej vitesh jep kontributin e saj për të pasuruar bibliotekën me libra në gjuhën shqipe. Gjatë takimit u diskutua mbi aktivitete të mundshme kulturore, si bashkëpunim i Ambasadës me Shoqatën Shqiptare të Grave “Drita”. Qendra e Botimeve për Diasporën ka dërguar rreth 400 tekste mësimorë dhe plotësues për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e kulturës shqiptare.

D Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Gjermani / Lazim Destani pjesë e forumit ballkanik mbi antisemitizmin



Këtë të mërkurë u mbajt forumi ballkanik online mbi Antisemitizmin, unik në llojin e vet. Forumi u organizua nga Combat Anti-Semitism Movement në bashkëpunim me Parlamentin e Shqipërisë. Pjesë e këtij forumi online ishte dhe filantropi Lazim Destani i cili ndoqi diskutimet për krijimin e një mburoje të fortë në rajonin e Ballkanit kundër urrejtjes dhe intolerancës, si dhe promovimin e bashkëpunimit në luftën e anti-semitizmit. Në këtë aktivitet i pranishëm online ishte dhe sekretari amerikan i shtetit Mike Pompeo. Teksa falënderoi Shqipërinë dhe popullin shqiptar, Pompeo tha se pas luftës dhe holokaustit ata ofruan një ndihmë të rrallë për hebrenjtë, duke i shpëtuar nga nazizmi. Javën e shkuar parlamenti shqiptar votoi në unanimitet një rezolutë për miratimin e përkufizimit të përdorshëm për antisemitizmin, të përcaktuar nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit duke iu bashkuar 43 vendeve të tjera që e kanë miratuar atë.

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).